



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 35/3 Prot.

Durrës, më 9.01.2020

VENDIM

Nr. 3, datë 9.01.2020

PËR

**"MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË
ME KOHË TË PLOTË, TË CILËT PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E
SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020".**

Në mbështetje të nenit 4 "e drejta e studimit", nenit 49 "Funksionet e bordit të Administrimit", nenit 98 "të drejtat dhe detyrimet e studentëve" të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 269, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me Vendimin nr 779, date 26.12.2018 të ndryshuar me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 40, date 23.01.2019, shkresës nr. 6216 prot., datë 25.11.2019 të Fakultetit të Edukimit "Përcillen listat e studentëve të ciklit të parë të studimeve, me mesatare 9 deri 10, të cilët përfitojnë përjashtim/reduktim nga tarifa e studimit si dhe për trajtimin me bursë për vitin akademik 2019 - 2020", Bordi i Administrimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 9/01/2020,

VENDOSI:

1. Përjashtimin në masën 100%, nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2019 - 2020, për 32 studentët të cilët vijojnë studimet në vitin e dytë ose të tretë në ciklin e parë me kohë të plotë, pranë Fakultetit të Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - o Administratori
 - o Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ilirjana NANO



TABELA PERMBLEDHESE MBI NUMRIN E STUDENTEVE TE CIKLET PARE TE CILET PERJASHTOHEN NGA
TARIFA DHE EFEKTI FINANCIAR
PER VITIN AKADEMIK 2019-2020

MIRATUAR

DATA 09.01.2020

Kriteri perjashtues													
Shkresa referuese	Fakulteti	Nr i studenteve te perjashtuar ne maen 100% nga tarifa e shkolllimit	Efekti financiar per vitin akademik 2019-2020 (ne leke)	Studente qe vijnë nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	Studente qe jane vete me aftesi te kufizuara	Studente qe kane statusin "jetim" ose kane humbur kujdestarin	Studente te shkolqyer viti pare sipas shkrases se QSHA -se nr 5534 date 20.11.2019	Studentët, të cilët kanë të dy prindërit pensionist ose njerin prind pensionist dhe tjetri nuk jeton	Studentët, të cilët tretët e lart në rradhën e familjeve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë student në institucionet publike të arsimit të lartë	Studentët romë dhe ballkano - egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga vetdeklarimi	Studentët romë dhe ballkano - egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga vetdeklarimi	Studentët fëmijë të ish te perndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër te denuar me heqje lire	Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy student
Shkresa nr. 6216 date 25.11.2019	FE	32	800,000				32						
TOTALI		32	800,000				32						